


BIBLIOTEKA

8JH-3

gj. 80

# BALIL GJINI



*Proza*

UEGEN


TRE  
GISHT  
NDER

8SH-3  
GJ 80

BALIL GJINI

# TRE GISHT NDER

*Proza*



Shtëpia Botuese UEGEN  
1996

Redaktor: **Xhevahir Lleshi**

Kopertina: **Kastriot Dervishi**

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara për botuesin

**Botues: Xhevahir Lleshi**  
**Shtëpia Botuese UEGEN**  
**1996**  
**Tel&Fax. 062 33486**  
**062 322 44**

## *Magjistarja*

Të mirën e ke në gojë të nepërkës, kaq tha magjistarja dhe shkopi i thantë i ra nga dora. Në shpinë më rëndonte thesi me rrangullat e qiellit: copra të zbërdhylta kaltërsie, luleshegë të vyshkura yjesh, maska e allçinjtë e hënës. Teksa magjistarja dha shpirt, shkopi filloj të lëvizë, të spërdridhet dhe të shndrohet në një nepërkë të mrekullueshme pikaloshe. Ungrit përgjysmë në lartësi, nxorri gjuhën dhe më përqeshi gjithë naze, pastaj iku tutje. Me vite të tëra e kërkova gur më gur, mur më mur, ferrishte më ferrishte. Herë e humbja e herë e gjeja përsëri. Maskë e hënës ma kishte shpuar thesin me rrangullat e qiellit dhe, duke derdhur prej andej yje dhe kaltërsi, ma kishte bërë peshën më të lehtë.

Më së fundi e takova përsëri. Në një lëndinë me bar të thatë ngrinte përgjysëm shtatin elegant. Flakën! Bari kërciste nën gjuhët e zjarrit, kurse ajo u ngrit dhe njëherë mes shtëllungave të tymit dhe u tund si një giresh mohues. Gërvisha me thua ciflat e shkrumbit të shtyllës kurrizore dhe poshtë tyre doli një gjerdan me perla lëbyrëse. E ngrita atë në dorë dhe, ashtu i varur poshtë, ai u shndrrua në një shkop të drunjë thane.

## *Një telegram të gjatë vetes sime*

Këtej nga të shkruaj s'ndihem aq mirë. Siç e di dhe ti, (se ne të dy bashkë kemi qenë), gjithë fatkeqësia ime erdhi për shkak të një peme. Ishte natë dhe për këtë s'ishte nevoja të shikoje xixëllimat e yjeve, por dy flakëza qiriri në sytë e një maceje zullumqare, që nxintonte drejt lulishtes për të shqyer prenë e vet: një kocomi, të cilin e mbante mes dhëmbësh. Në këtë letër s'është vendi për të të spjeguar ç'duan ata qirinj në sytë e një maceje, ndërkohë që duhet ta kenë vendin në kishë, as për të të thënë se flakëza të tilla i kam parë në sytë e të gjithë meshkujve kur takojnë të dashurat. E, pra, atë natë s'kishte këmbë njeriu, sepse njerëzit e qytetit tonë merren me punë më serioze se sa një shëtitje: p.sh me mbledhje, me gjakosje hundësh për shkaqe parimore e plot të tjera sojesh; veçanërisht imitimi i gëçshërimit të trungjeve të hardhive (ata mpleksin këmbët në një krevat që e quajnë bashkëshortor) u jep një kënaqësi drithëruese. Të thashë, pra, që s'është nevoja të të shpjegoj se përse hardhitë e bëjnë këtë mpleksje në mes të

ditës, kurse njerëzit në mes të natës, të fshehur mbas gjithfarë perdesh, çelsash e bravash. Atë natë unë dhe ti (ti si gjithmonë i fshehur pas brinjëve të mia) shëtitnim krejt të qetë. Befas pamë, ose më mirë unë pashë, që në trotuarin përballë po vinte një pemë. Ajo, pasi u ra dy-tri herë në murin anësor këpucëve të mëdha të rrënëjëve për t'i shkundur nga balta, u afroa drejt meje, dmth edhe drejt teje. U përkul mbi veshin tim për të thënë diçka, po aq sa përkolem edhe unë ku kafshoj bulkthin e veshit të të dashurës sime shtatshkurtër. Ishte një mështeknë e sëmurë nga lija, gjë që kuptohej fare lehtë nga njollat e bardha që kishte në trup e në duar. Ti më godite në brinjë dhe më pëshpërte nga brenda veshit se ishte turp të ndalonim në rrugë për të biseduar me një pemë, se njerëzit seriozë ndalojnë në rrugë vetëm atëherë kur duan të takojnë deputetë e ministra se...e plot fjali të tjera që fillonin me lidhësen graminore “se”, lidhëse e përdorur mjaft mirë nga intelektualët e qytetit tonë, kur analizojnë nëpër tribuna fenomenet e reja të jetës. Unë të kuptova shumë mirë: krenar që i përkisje asaj race të zgjedhurish, ti s'mund të më flisje ndryshe veçse me lidhësen “se”, por dhe unë, siç e kemi biseduar me dhjetra herë të tjera, kam dobësitë e mia. Mbi të gjitha që ajo ishte e sëmurë dhe ishte e vëtmja mështeknë në qytetin tonë. Qysh në fillim ti dyshove për flirtim nga ana e pemës. Këtë e kuptova nga dy përcëllima të vogla zjarri që më vinin që poshtë brinjëve, të cilat më shkaktoheshin nga dy flakëzat e qirinjve, të atyre pra që u ndizen në sy maceve, ose meshkujve, si të duash merre. Po të betohem në kokën e mështeknës që jo. Në ato çaste ajo më kërkoi veç një nder: t'i shëroja plagët meqë e dashura ime punonte në farmaci. Dashuria filloj më vonë. Filloj gjatë atyre mbasditeve kur unë

i lyeja plagët. Fatkeqësish sëmundja e saj ishte e pashërueshme. Kjo ma shtoi dashurinë dhe keqardhjen. Se dashuria s`është gjë tjetër veçse keqardhje. Pasi i pronëson tiparet më të mira të dashurës, tek i dashuruari vjen velja prej ngopjes, velje e cila lind pastaj neverinë; por mund të ndodhë dhe tjetra: të dashuruarit mund t’i vijë keq që tiparet e të dashurës s’do t’i ketë gjithmonë të vetat, që çdo ditë ato po firojnë dhe po kthehen në origjinën e fillimit: në baltë; e çfarëdolloji qoftë kjo baltë: e artë, apo e bajgët.

Dashuria me mështeknen s’më kushtonte asgjë, sepse trupi i saj ishte i lakuriqtë dhe s’i ngjante fare trupit shtatshkurtër të së dashurës sime, i cili ishte i mbërthyer me gjithfarë pulla e susta. E di që do të thuash se një dashuri e tillë është mëkatare, siç e di që është e ndershme të dashurosh të gjitha fjalitë që fillojnë me lidhësen “se”. Po unë s’i bëja keq asnjeriu. Dhe mos harro: mështekna ishte krejt fillikate. Aty, tek dera e varrezave, ku kishte shtëpinë, vërtet i bënin hera-herës shoqëri zogjtë, po ata me këngët e tyre ia lëndonin plagët më shumë; se edhe zogjtë, të thuash të drejtën, sikur janë prishur ca duke marrë zakonin e fjalomanisë së njerëzve. Ç’të bëjnë të shkretët: më thuaj me kë mri, të të them se cili je. Bile, siç e mora vesh më vonë, këto zakone kishin filluar të ndikonin dhe tek mështekna. Ajo, ndërsa përqafohet me mua, tinëz, me rrënje, përqafonte e mbështillte koskat e një të vdekuri në varrin përballë. Ia fala tinzarillëkun, jo vetëm nga që rivali im ishte një i vdekur, por edhe nga që e dija që këtë e bënte e ndikuar nga vajzat e qytetit tonë. Asnjë e keqe s’më erdhi nga kjo. Fatkeqësia më ndodhi më vonë. E dashura ime (jo pema. por vajza farmaciste që ti e njeh) kishte filluar të dyshonte për gjithë ato tubeta e pomada që unë harxhoja dhe

sa herë takoheshim s'i ndizeshim më ata qirinj që shikohen tek macet. Sytë i kishin marrë një ngjyrë të ftohtë, thua se notonin në ta copra parafine. I trembur ndaj këtij rreziku shkova të kërkoj pomada tek disenjatori më i talentuar i qytetit (edhe ky një nga intelektualët e "se"-së), i cili, për hir të miqësive që kishte me vajzat, mbante jo vetëm perfume, por edhe turlilloj ilaçesh e shishkash. S'u gabova. Në një kavalet të lënë mënjanë, prej të cilët vinte akoma erë e freskët boje, ishte vizatuar një peisazh. Titulli poshtë: "Nudo". Ishin dy kodra në mes të të cilave ishte vizatuar një pemë. Çudi! Ndonëse pema kishte pamjen e një organi mashkullor, s'mund të thoshja që s'e njihja: po ato njolla të bardha, po ajo hijeshi e krehjes së floknajës së gjelbër si të mështekjnës sime. Kurse ajo rrumbullaksi e kodrave, sa më shumë e shikoja, aq më shumë më krijonte ndjesinë e përkëdheljes. Në fillim s'e kuptova nga se më shkaktohej një ndjesi e tillë, por pastaj...pastaj...dreqi ta hajë! Një kurbë të tillë rrumbullaksie kishin dhe dy hënëzat e të dashurës sime farmaciste. E vështrova disenjatorin në sy. Ai ia shkrepit të qeshurit. Pra gjithçka ishte evërtetë. Unervozova. Mirëvithet etë dashurës sime(derisa do vetë) mund të variojnë sa nga një studio disenjatori në tjetrën, herë në formë kodrash, herë në formë mollësh e bostani, a gjithfarë perimesh të tjera, po mështekna ç'donte aty? Dhe për më keq: e përcudnuar si çdo gjë që prek dora dhe syri njerëzor.

T'i tregova të gjitha këto, sepse në çaste të tillë ti je shkëputur prej meje, prej çilimillëqeve të mia. -siç i quan vetë. - dhe je marrë me punë të tjera serioze (gjithnjë siç i quan vetë). Çastin e grindjes ti e di. E di dhe mbërritjen e ambulancave dhe shtrimin tim në spitalin psikiatrik. Siç di

dhe unë që ti u fyejte shumë nga të qeshurat e mjekëve dhe veçanërisht nga ajo fraza: ky i marri na dashka një pemë. Fyerje që të bëri të shkëputesh përgjithmonë prej meje.

Të thashë qysh në fillim që këtu s'ndihem aq mirë. Shkaku është mungesa e mështeknës. Njollat e ndryshme në përparëset e infermierave ma bëjnë më të dhimbshëm kujtimin për të... Shpesh ndjej një boshësi të tillë brenda vetes sa më duket se do të fluturoj. Kjo vjen nga mungesa e materisë (dmth nga ty). Në çaste të tjera ndjej një si gërryerje në organet e sipërme. Më duket se mes tyre çan me rrënje e do të mbijë një pemë. Tani, pasi të hapësh fjalorët dhe enciklopeditë serioze, dua të më përgjigjesh: a pllenohet një pemë përmes gojës së një mashkulli vetëm me puthje? Po qe se po thuaju këtyre mjekëve të çmendur të më nxjerrin nga spitali dhe të më shtrojnë në një maternitet: pas...(ti e di kohën e shtatzanisë) do të lind një mështeknëzë. Qysh tani je i ftuar.

Unë, pjesa jote e divoruar.

## *Galloshja e vjetër*

Një mbasdite në dhomën time hyri një galloshe e vjetër. U ul e heshtur në fund të krevatit dhe më nguli sytë e zinj llastikorë.

- E, - më tha - çuditesh me mua, ë?! Me vete thua: nga më mbiu në prag kjo zhardë plakë.

- Ju lutem - belbëzova i zbehtë - po unë s'ju njoh fare.

Unë...

- Aaa! Po unë prandaj kam bërë gjithë atë rrugë çalë-çalë, përt'unjohur së bashku. Jam e nëndheshmja, e pabukura, e poshtëruara.

- Asgjë s'po kuptoj!...

- S'ke si ta kuptosh, se po ta kuptoje s'vija këtu. Ja, merr qytetin tuaj: lart janë perënditë,ënëgjëjt. Poshtë janë demonët, djajtë. Sipër tij janë bustet, pemët, zogjtë; janë puthjet, të qeshurat, tradhëtitë dhe brengat e vogla. Poshtë janë ujrat e zeza, gjirizet, sëmundjet. Lart është kundërmimi, poshtë është kutërbimi.

- Ju po flisni në mënyrë të tillë sa po më detyroni të ze hundët me dorë.

- Sss! Mos u nxitonil! Kur vdiqa, edhe mua, si gjithë gjërat e poshtëruara, më kapën nga këmbët dhe koka dhe më flakën në rrugë. Pastaj një fëmijë më zuri nga cepi i grisur i xhaketës dhe më flaku në grykën e hapur të një pusete. Errësirë, vetmi, tmerr. Po për fat s'vazhdoi gjatë. Një mi dhe një miushe u futën brenda meje dhe fjetën së bashku me ditë e net të tëra. S'ishte nevoja të përgjoja nga vrima e çelësit, siç bëja kur përgjoja dashuritë e zonjës sime, në kohën kur isha gjallë. Miushja s'kishte xheketa, triko e këmisha nate për t'i zhveshur. Ata përqafoheshin, puthesin e bënин dashuri fare pa turp. Eh, si cicérinin! Prandaj të them se minjtë janë zogjtë e të nëndheshmes. Branda barkut tim mbajta fëmijët e tyre: tre qenie të verbëra pushralla, të pafajshme.

Brrr!, pasthirmova duke fshirë majat e gishtave në batanije me ndjesinë se në ta më ishte ngjitur pushi i atyre bishëzave të pështira që të shtinin krupën.

Galoshja e vjetër hapi gojën (o zot, atë gojë nga kishin hyrë dhe dalë një tabor me minj) dhe qeshi. Më shumë se gojë ajo ishte një gollë e zezë brenda së cilës s'kishte asnë dhemb.

- Do të mësohesh - tha me qetësi - do të mësohesh. Kështu ndodh me të gjithë në fillim. Ju përsipër keni macet, ne përposh kemi minjtë. E ç'janë macet? Ca qenie që gérhasin gjithë ditën dhe pastaj me mjaullima të poshtra ngjiten çative të fqinjëve për t'u dashuruar. Çative, duke lëvizur tjegullat e duke iu prishur qetësinë njerëzve me mjaullimat e tyre. Kurse ju e quani qytetërues aktin e tyre.

- Të gjitha këto janë të turpshme.

- Të turpshme?... Sigurisht kështu gjykon i ju, njerëzit.

Turpi për ju është i pabukur, i shëmtuar, i poshtëm. Lart është

nderi: i vyrtytshëm, i adhurueshëm. Ju s`doni ta besoni atë që mendoni: ndërsa flisni përvyrtytin, mendja ju shkon gjithmonë tek turpi. Kur isha gjallë...

- Pse tani mos jeni fantazmë?

- Merre si të duash. Pra, kur isha gjallë, për herë të parë dhe të fundit kam qenë në një gosti të madhe. Shandanë me qirinj, verëra me marka të çuditshme, fustane farfuritëse femrash, muzikë, qilima persie. Ne të përbuzurave të racës sime na lanë në korridor. Rasti e solli të kisha fqinjë një këpucë të mrekullueshme Ilustrafine, e cila ishte bërë aq derr nga mërzia sa arriti të më sajdiste dhe mua. Pas mesnate, kur njerëzit u shpërndanë, këpuca lustrafine më pëshpëriti tek veshi: eja të shikosh, më tha, eja! Më çoi tek një derë dhe ma bëri me gjest të vija syrin tek vrima e çelësit (thonë se nga ky zanat janë zvogëluar bebëzat tonë), kur ç'të shikoj?! Mbi krevat, ndërsa zonja po zhvishej (të thashë që miushja nuk zhvishej kurrë), rrinte një qen. Angullinte mybutur dhe i kullonin jargë nga goja. Qeni futi kokën në gjoksin e zonjës dhe me putra i çukërmonte gjinjtë. Pastaj s'pashë dot gjë s'e drita u fik. E pra zonja ishte një nga më të vyrtytshmet e qytetit tuaj, e njojur për veprat e saj bamirëse.

E shikoja dhe mendoja: ta marrë djalli!, nga e di kjo dreq galloshe thashethemet rrëth vajzës së qeveritarit të lartë P, thashetheme që kishin qarkulluar kaq kohë në qytetin tonë. Ku e gjen kaq urrejtje kjo copë llastikë që dashuritë e minjve i quan më fisnikë se dashuritë njerëzore. Duke i qëndruar besnik tonit me të cilin kisha folur më parë, por tani më me butësi, i thashë:

- Arti duhet të merret me çështjet e mëdha, të bukura, sublime.

- Budalla - më shtypi ajo majën e hundës duke qeshur.
- Që këtu fillojnë keqkuptimet. Jam e vuajtur unë. Kam parë shumë në këtë botë dhe në atë botë. Kujton se kam shumë nevojë për ty? Jo. Je ti ai që ke nevojë për mua.

Pastaj u ngrit në këmbë, më buzëqeshi me dinakëri (ah, do të merremi vesh, do të merremi!), dhe pa thënë asnje fjalë iku duke tërhequr pas këmbën e vet të çalë.

## **Dylbitë**

Njerëzit e qytetit tim i kishin lënë mënjanë dëshirat për të blerë sýze të markave të fundit, sepse i kishte kapur mania e dylbive. Askush nuk e dinte me siguri ç’i shtynte të vepronin kështu: lodhja e mërzia nga sytë e tyre që s’bënин gjë tjetër veçse e pasqyrönin botën ashtu siç ishte, apo kërshteria prej mistereve që thoshnin se e kishin dylbi të tillë. Flitej se dylbishitësi i kishte blerë ato larg, larg, në një vend ku njeriu jetonte nën hijen e rigonit. Sigurisht që kaq s’mjaftonte për të kuptuar në se në atë vend rigoni bëhej i lartë sa një lis dhe njeriu rrinte natyrshëm nën hijen e tij, apo njeriu ishte i vogël sa gishti dhe rigoni po aq sa rritez dhe në kodrinat e qytetit tonë. Banori i parë që provoi një dylbi të tillë, pra vetë Toni, ishte habitur nga ajo ç’kishte parë: njerëz të lakuriqtë, fare gollomesh, ecnin rrugëve në punët e tyre. Më tej, ndonse ishte maj, pemët e zhveshura nga gjethet duke shin si ca skelete të zinj. Kjo ishte bërë më e besueshme kur ai filloi t’ju fliste gjimnazisteve për nishane e shenja të tjera në pjesët e trupit, të cilat i dinin ato dhe pasqyrat e dusheve të tualetit. Ato e dëgjonin të tronditura e të skuqura, me një ndjenjë fajt

e rrëqethjeje njëkohësisht. Dylbitë në fillim i blenë më të rinjtë, pastaj njerëzit me prirje liberale, gjersa erdhi koha që të gjithë shtysheshin në radhë për të blerë një syresh.

Në qendër të thashethemeve të dylbimbajtësve u vunë shtëpitë e vjetra namuzqare, ato që dritaret i kishin sa një frengji. Falë veticë të dylbive të reja që çdo gjë e shikonin ndryshe, pra tej mureve të trashë e të zymtë shikonin si përmes xhamash transparentë, flitej për meshkuj të veshur rëndë në këto shtëpi dhe që zhgrysheshin shtretërve me gra që ishin veshur po në të njëjtën mënyrë.

Kaluan vite dhe njerëzit s'i hiqnin më dylbitë nga sytë me përjashtim të njerit: mjekut psikiatër të qytetit. Ai u fliste njerëzve për një epidemi marrëzie që kishte pushtuar qytetin, u thoshte se lakuriqësia e tyre ishte një sëmundje kolektive, pra njëloj si në kohët e qëmotshme, kohë kur njerëzit s'i kishin blerë dylbitë. Por njerëzit e qytetit tim janë të gjerë e bujarë. Ata i nënqeshninë embëlsisht dhe i rrinjin shpatullat miqësish, duke i dhënë të kuptionin njeri-tjetrit se një njeri që merret me të marrët...ehu! i shkelnin syrin njeri-tjetrit. Kështu, me një marrëveshje të fshehtë, gjithë qytetarët e patën mjekun pacientin e tyre. E qetësonin me fjalë, i rekordonin ilaçe farmacie e barna popullore.

Namuzqarët e vjetër, ndërkaq, s'mund të linin të përgojoheshin kështu emrat e tyre. Ishin ata të parët që i shembën shtëpitë e zymta prej guri dhe ndërtuan shtëpi prej qelqi. Gratë e këtyre shtëpive filluan të rrinin ashtu siç ua lejonte sëra dhe edukata: të lakuriqta, por për hir të veticë të dylbive dukeshin të veshura mrekullisht. Vetëm mjeku psikiatër thoshte se ato ishin lëkurëbardha si xhinde, po të gjithë e dinin kush ishte ai dhe ia kishin hequr fillin. Shembullin

e shtëpive namuzqare e ndoqën dhe të tjerat dhe çdo të sëmuri nga sytë tanë i rekombinohet të shohë atë flakërimë rrrezesh diellore mbi çatitë e xhamta në agim dhe në perëndim dhe shërimi është i sigurt.

Erdhi një kohë kur dylbitë në dyqanin e Tonit s'i blinte më kush, sepse të gjithë, me përjashtim të mjekut, i kishin blerë ato prej kohësh. Një ditë njerëzit që kalonin andej s'panë në vitrina dylbi, por ca syze të allasojshtme me marka të çuditshme. Njerëzit mërmëritën të pakënaqur, sepse dukej ashiqare që Toni donte t'i kthente në kohën e qëmotshme, kohë kur e shikonin botën me sytë e tyre të bezdisur. Më të çuditshme ishin fjalët që filluan të qarkullonin për dylbitë: se të parën prej tyre ia kishte marrë plakës Hanushe. E po ky ishte kulmi! Hanushja ishte ajo plaka e lekkosur e azilit që kishte bërë bashto në moshën gjashtëdhjetëvjeçare. Ky bashto, ashtu i përcudnuar, mbahej në një nga vazot e maternitetit. Ishte folur vërtet për një palë dylbi të saj, por ajo ishte më shumë një lodër kalamajsh, e mbushur brenda me letra transparente me ngjyra. Fundja po të mos kishte manira kalamajsh Hanushja nuk do të bënte atë që bëri. Toni kishte thënë se dylbitë që i kishte shitur qytetit ishin modeluar sipas modelit të saj. Por njerëzit e qytetit tim s'janë vetëm bujarë, por edhe të mençur. Ata e kuptuan që Toni e kishte sajuar këtë histori naivë nga hallet financiare, nga që s'po i shiteshin më dylbitë. Qysh të nesërmen ata mblodhën një sasi të hollash si ndihmë dhe ia çuan në dyqan. Po Toni jo se jo. Ulërinte, sokëllinte, u thoshte se ishin lolo, idiota klasikë, gaforre të ndryshkura, përderisa e besuan atëherë kur i kishte gënjerë dhe s'e besonin tanë që u thoshte të vërtetën.

Ditët që pasuan Tonin e çuan në spital dhe aty, që prej

dritareve të hekurta, ai shante njerëzit, qytetin, Krishtin, Muhametin. Njerëzit e qytetit kthenin kokën andej me keqardhje dhe mërmëritnin lutje për njeriun e sëmurë. Keqardhja për të shtohej më tepër nga që e dinin që mjeku, i cili duhej ta shëronte, kishte kohë që ishte sëmurë për vete.

## *Tre gisht nder*

As unë s'e di ç'më shtyti të shkoja për herë të parë në shtëpinë publike: ndofta kurioziteti që ka çdo mashkull që vjen nga një vend si i imi, ndofta nevojat fiziologjike që ka çdo burrë normal.

Pronarja më hodhi një tufë fotosh mbi tavolinë. Për fatkeqësinë time zgjodha një vajzë me tipare koreaneje. Mos paça këtë dhëmb në të gënjej, (dhe i ra me thoin e gisshitit tregues të vetmit dhëmb që kishte në nofullën e sipërme), këndonte cërr-cërr si selçë. Asgjë s'kuptoja ç'thoshte e kjo ma ndiste më shumë dëshirën. Për dy sekonda u zhvesha lakuriq dhe iu hodha sipër. E përkëdhela me duar tek supet, ijet, vithet. S'lashë pjesë të trupit pa ia lëpirë me gjuhë: në fillim tek thithkat e gjirit, pastaj gjithnjë e më poshtë. Rrënkoja si derr, po dhe ajo ishte bërë ujë në djersë.

Sa herë kaloja andej, ajo dilte në dritare dhe më thërriste me një greqishte të çalë: ela, Landi, ela! Kala seks. Pas asaj pune të lodhshme prej refugjati, argëtimet me të ditëve të shtuna, u bënë e vetmja kënaqësi. E ç'mund të bëja tjetër mes asaj vëtmie ulëritëse?! Apo mos duhet të rrija

shtrirë në atë depon që mbante era ekseklorant, mes minjve, që ishin aq të mëdhenj, sa çdo mace do t'ia mbathte nga frika? Kur erdhëm në fillim refugjatë ne zgjidhnik çdo lloj fejmre, por pastaj pronarët ndryshuan qëndrim: na nxirrin vetëm fotot e vajzave të vendeve lindore. Thoshnin se ne donim shumë kohë të vinim në qejf dhe i raskapitnim vajzat. Ti e kupton vetë: ata, pushtat, prisheshin njëherë në WC-të, pastaj ngjiteshin lart në dhomat rozë. Kurse unë, s'kam bërë kështu asnjëherë. Mos paça këtë dhëmb në të gënjej. Ja e dëgjon si tingëllin: si bemol maxhor, do diezis, a si i thonë... Kurse ajo kuçka merrte këmbën e majtë, e shtrinte mbrapa dhe mbështeste kokën tek thembra. Buzët e seksit i shtrembëroheshin anash si atyre që iu bie domlla.

Një të shtunë s'e takova dot koreanen time. Pronarja më tha se ishte e sëmurë dhe nuk do të shërbente. U ktheva i mërzitur në dhomën time. U përpoqa mos flija, por ishte e kotë. Andej pas mesnate, u çova dhe kapa një miush të madh. Mora një gëershërë dhe fillova t'i prisja mustaqet. Në mënd më vinin fjalët e një kënge për dhëndrin që ruhet dhe pret mustaqet para se të shkojë tek nusja. I çmendur, fare i çmendur; të tillë e bën njeriun vetmia.

Të shtunën e radhës shkova përsëri. Ishte. U ngjita në dhomën e saj. Kishte veshur getat e zeza dhe kishte një pamje që s'di si ta them: të zyrtë, të menduar. Por habia s'ishte kjo; habia ishte, kur më foli me një shqipe të kulluar:

- Erdhe prapë?!...I shkreti Landi! Kalë samarlli, kalë i tredhur ngarkese.

Me siguri duhet të kem qënë i hutuar si buf, përderisa bëra pyetjen më të pakuptimitë:

- Ju jeni nga Shqipëria?!

- Çdo të thotë: "Shqipëria"? Kush është Shqipëria? Mos është ai vendi që veç këlyshëve të qenve pjell edhe njerëz dhe që, po ashtu siç kap nga veshi këlyshët e bushtrave dhe i hedh në humnerë, po ashtu kap vajzat e veta dhe i flak ku të mundë? Apo ai tjetri ku jeta e çdo vajze matet me tre gisht nder?... Tre gisht nder mes kofshëve të tyre.

Vente e vinte nëpër dhomë, e inatosur nga shkaqe që s'arrija t'i merrija me mënd. Nuk dija në duhet ta qortoja, apo ta ngushëlloja, ndaj ia këputa kotmëkot:

- Më fal... Sjelljet e mia... E them nga që je nga atdheu im.

- Prapë ti?... Budalla që bëhesh! A e di ç'është atdheu për mua tanë?

Ajo uli poshtë getat e zeza dhe tregoi me gisht një vijë blu, me të cilën ishte rrethuar seksi i saj. Ishte nga ato lloj vijash që, pasi shpohen me gjëlpërë, mbushen me bojë; nga ato me të cilat ushtarët vizatojnë në krahë figura vajzash, luanësh a sirena deti.

- Ky është atdheu - tha ajo duke treguar përsëri atë vijë, e cila i ngjante perimetrit të hartës së Shqipërisë. - Eja, ç'pret? Unë e di që ju refugjatët e tjerë thoni se atdheu ynë është bërë për t'u shkërdhyer. Eja ç'pret?! Bjerë përmbyss mbi mua dhe ke rënë mbi atdheun.

Një inat i parrëfyeshëm mund ta detyronte një vajzë të fliste kaq ashëp. Unë ula kokën dhe dola përjashta pa thënë asnjë fjalë. Qysh atëherë s'kam shkuar për ta takuar më dhe veç për një gjë më vjen keq: që s'ia mësova dot emrin. Emrin, në se kishte, sepse gjithë soji ynë s'guxojmë të rrojmë me emrat tanë.

## *Makina e zezë*

Sipër inat të bestytnivendjellakeqetë gjyshes, gjesteve inatçore të fqinjti tonë memec si dhe zymtimit të fytyrave tona, ajo kishte ardhur përsëri. Brumbull i zi që kishte zhuzhërritur rrugëve të qytetit, makina e vdekjeve, pasi kishte përshkuar gjithë rrugët dhe rrugicat prej qendrës deri tek shtëpia jonë në periferi, kishte ndaluar përsëri ngjitur pas murit të oborrit tonë. S'ishte nevoja të dëgjonim zhurmën e motorrit a borinë e saj. Kishin mjaftuar thirrjet alarmuese të Shuaipit: lla, lla, lla, që ne të delnim në ballkon: babai, gjyshja, dy vëllezërit dhe unë. Tek e shihja më dukej se trëndafilitat vjeshtorë, që vareshin poshtë parmakëve dhe që ajo i prekte me shpinën e zezë, pas pak do të shkrumboheshin e do të jepnin shpirt prej kontaktit me të.

Asnjë njeriu s'i pëlqen që mu përpara hundës të shtëpisë së vet të vijë e të rrrijë makina që ka çuar të vdekurit në varreza. Në këto çaste i vijnë ndër mend turmat e grave që mbysin ngashërimat në shamitë e hundëve, balta përsipër të vdekurve dhe fotot e tyre mbi qivure; ata me fantazi më të guximshme shikojnë dhe kufomën e vetes të shtrirë në

arkivol dhe të transportuar nga kjo makinë. Përderisa këto ndodhnin me këdo s'kishte si të mos ndodhnin edhe me ne. E pse pa? Hiç, kot fare, vetëm nga kokëshkrepja e një shoferi. Ishte kjo arsyje që babai kishte shkuar qysh herën e parë kur erdhi ajo, këtu e një muaj më parë, për t'u ankuar tek drejtori i komunales.

- Kam ardhur për makinën e vdekjeve - i kishte thënë ai.

Drejtori, i keqkuptuar, kishte hapur në fillim sytë dhe kishte rrrolur i besdisur ballin. Pastaj, duke kuptuar se s'ishte fjala për atë që mendonte ai, por për diçka tjetër, kishte thënë:

- Po pse?... Ajo është fringo e re, dëshmi e përpjekjeve që bën shteti për përmirësimin e shërbimeve ndaj njerëzve.

Babai ia kishte thënë atëherë troç të gjitha. Drejtori e kishte dëgjuar me njerzillëk, i kishte thënë se i kuptonte arsyet e tij dhe se veprime të tilla nuk do të përsëriteshin. Po ku e linte Shuaipi babanë. Lla, lla, lla, ia bënte ai duke kthyer gishtin e madh drejt gojës, gjest i atyre që kërkojnë të pinë ujë.

- Njëherë kur po kthehesha në shtëpi - fola unë duke ndërprerë për një çast babanë që po na tregonte - makina më kaloi përpara dhe m'u duk se brenda këndonin zëulët një këngë.

- E zeza, unë, e zeza! - tha gjyshja. - Kanë qenë shpirrat e të vdekurve. Pastaj, pasi kishte ngritur sytë nga qelli dhe kishte bashkuar duart në gjoks, kishte bërë nojma duke mërmëritur ca fjalë që s'arrija t'i kuptoja...

Por as ankesat e babait (ai e kishte takuar edhe dy herë të tjera drejtorin), as lutjet e nomatisjet e gjyshes s'kishin pirë ujë. Makina kishte ardhur përsëri duke hedhur duhma vdekjeje

mbi dritaret, pullazin e pëllumbave dhe fytyrat tonë.

- Xhaketën! - i ulëriti babai nënës.

Unë i shkova pas. Lla, lla, lla, bënte Shuaipi, duke e kapur babanë nga krahu dhe duke përsëritur gjestin e tij të zakonshëm.

Shoferi s'ishte në timon. Dolëm nga mbrapa. Babai kapi dorezën e derës me ndrojtje dhe e hapi. Por brenda (o tmerr!), brenda... Në mes të makinës, aty ku vendosej arkivoli, kishte dy arka të mbuluara me gazetë, mbi njerën prej të cilave kishte një shishe me raki; mbi dysheme ishin flakur koska mishi... Brenda ishte ai që s'ta merrte mendja: drejtori i komunales dhe dy shokë të tij. Ushqimet me siguri ishin marrë nga ndonjë drekë e përmortshme dhe ata, duke iu fshehur syve të kalimtareve, vinin për t'i shqyer këtu në periferi. Lla, lla, lla, bëri Shuaipi duke përsëritur gjestin dhe duke treguar me gisht drejtorin. Babai, dyllë i verdhë, pa thënë asnjë fjalë, përplasi derën dhe u largua.

Ditët e mëvonshme makina e të vdekurve s'u duk më para shtëpisë sonë. Një ditë, kur një i njojuri im më tha se nga makina e të vdekurve kishte dëgjuar një si mërmërimë këngë, mua m'u kujtuan fjalët e gjyshes për shpirrat e të vdekurve dhe qesha hidhur.

## *Më tha një palmë*

Mbrëmë, në trotuarin përballë, pashë të ecëtë shpatullakërrusur, mbështetur mbi një shkop, një palmë plakë. Ndaloj. Përplasi mbi asfalt brashnjat e rrënjeve për të shkundur baltën dhe lotngashëryer më tha:

- Deti vdiq mbrëmë. Asgjë heroike s'kishte në vdekjen e tij. Askush tjetër s'e pa me përjashtim të çajkës së brengës sime që fluturonte me zorrët përjashta përcikas me të dhe klithe. Askush. Çudi sa pak eshtëra kishte. Ca koska gjithë nyje si të një kali plak. Në gropën e braktisur prej rrënjeve të mia ia kalla ato kokalla të gjora. E fyer në idolaltrinë time të përjetshme ika. Nekrologjitetë e vdekjes së tij, i kam vendosur vetëm në qoshet e humbura të periferive të qyteteve.

Kaq tha dhe iku duke brejtur mes gulsheve thonjtë e gishtërinjve të gjethëve. Dhe unë, i hutuar, akoma s'e di: dhimbja e saj vinte nga vdekja e Tij, apo nga zhgënjimi ndaj Vetes.

## *Milingonat*

Sot ishte ditë pushimi dhe unë vendosa t'i bëj një vizitë mikut tim të fantaksur, Xhimit, të cilin kisha dy vjet pa e parë. Shtëpia e tij ishte në periferi të qytetit, e rrethuar nga varre të vjetër dhe lisa shekullorë. Mes qetësisë dhe paqes miku im biolog studionte jetën e gjithfarë gjallesave: gjinkalla, flutura, miza dhe po të kishte fat e të çaheshin tubacionet e ujrave të zeza, edhe të mushkonjave.

Trokita në derën e jashtme. U dëgjua një zhurmë hapash që, nga mënyra si ecnin, kuptohej që ishin mbështjellë me pantofla. Porsa u hap dera shtanga i frikësuar dhe instiktivisht duhet të kem vendosur duart mbi fytyrë. Përpara meje qëndronte një qenie e çuditshme. Ishte e gjatë sa gjysma e shtatit tim, me një ngjyrë të tillë sikur porsa kishte mbaruar pushimet në det. Kishte një bel të rrumbullakët e të përkryer dhe dy krahë të bardhë si krahë ëngjëlli. Duke parë stepjen dhe frikën time, ajo buzëqeshi ëmbël dhe me një shtrirje plot kortezi të dorës, më tha:

- Cptz, hyni ju lutem, gshrrhv, zotëria ju pret.
- ?!

- Ne që parandjemë tër(gld) metet dhe shirat s'kishim si të mos e parandienim vizitën tënde. kështu që e lajmëruam zotërinë ca çaste më parë.

Ecëm përgjatë korridorit. Ajo përpara dhe unë, krejt i shushatur, nga pas. Kishte një tundje nazike të supeve dhe të vitheve, sa më bëri të mendoj që instiktet seksuale të të gjitha vajzave janë të njëjta me të gjallesave të tjera. Krijesa e çuditshme hapi derën e dhomës ku duhej të ishte Xhimi, përkuli lehtë kokën dhe u largua.

- Xhim! - thashë, porsa u mbyll dera. - Ç'ka ndodhur kështu me ty? Ç'është kjo qenie dhe çdo ajo në shtëpinë tënde?

- Qetësohu! - më tha Xhimi - Qetësohu! Klthr, milingonë është, ç'të jetë tjetër? Sigurisht më e kulturuar dhe më e madhe se thneglat ordinere. Tani ajo di të flasë në gjuhën e njerëzve. Krijimi i kësaj race ështe frut i punës sime njëzetë vjeçare me insektet. Me to i bëj dhe një shërbim qytetit: me që milingonat e parandjejnë shkëlqyeshëm të ardhmen, njerëzit s'kanë pse hedhin fall në gjithfarë arixheshkash; ja ku i kanë ato.

S'po e mblidhja dot veten dhe për t'u qetësuar e ftova Xhimin të bënim një shëtitje në kopësht.

- Aaaa! Ma kanë ndaluar ato, - tha, duke treguar me gisht diku pas perdeve të rënda të dritareve.

Pamja që pashë kur hapa perdet ishte sa misterioze dhe e frikshme, aq dhe magjike njëkohësisht. Me qindra milingona të mëdha, pa atë irregullin e irreshtit ushtarak që kanë thneglat e zakonshme, lëviznin sa nga njeri cep në tjetrin. Disa prej tyre kishin një drithë lëbyrëse në krahë, sa. më shumë se milingona, ato duhet të ishin fantazma të dala nga

varret aty pranë. Perëndia të bekoftë Xhim, mendova me vete, pa e ditur në se krijimi i këtyre qënieve ishte një gjë e vitytshme, apo e vesshme.

Të ulur rrëth tavolinës biseduam gjatë rrëth milingonave dhe gjallesave të tjera me të cilat merrej Xhimi. Ai, duke më treguar gjithfarë pincash, darësh, pomadash, ilaçesh, kthettrash e krahësh, më spjegoi se krijimi i kësaj race të re s'ishte aq i lehtë. Prishja e proporcioneve dhe gjigandizimi i tyre ishte rritur po aq sa dhe gjërat e tjera të pjesëshme që s'viheshin re kur ishin thngela. Gjuha, psh. Mendohej që thneglat s'dinin të flisnin. Gabim. Ato kanë një të folur bashkëtingëllor të çuditshëm: cptz, mnthl...Xhimi e dinte se ç'kishte hequr përt i copëtuar këto grupe bashkëtingëllorësh të ngjitura si me tutkall dhe t'i bashkonte me zanore e bashkëtingëllore të tjera për të krijuar gjuhën njerëzore. Shpesh milingonat e rritura nuk hiqnin dorë nga disa vese që u kishin mbetur që nga fëminia. Ndonjëherë, p.sh. ato limin shtretërit e rehatshëm dhe futnin kokën mes baltës nga malli për galeritë e nëndheshime.

Ishte mbasdite vonë kur u largova. Kureshtja dhe një ndjenjë e paspjegueshme mëkatë më çuan përsëri të nesërmë tek shtëpia në periferi të qytetit. Në dhomën e ndënjos më priste një surprizë e pakëndëshme. Dy milingona të rritura mbanin për krahu një shoqen e tyre këmbëthyer.

- njfgr, eh zotëri - zuri të flasë ajo, duke më vështruar me ca sy të turbullt pendestarë - dikur kur ishq fëmijë ju më keni shkelur pa dashje. Po unë di të fal. Unë jam tolerante.

- E dëgjon - foli Xhimi. - Ato pavarësisht se vijnë nga birucat e nëndheshme (trimzhk) dinë të falin. Kurse ne, ah ne, na ka pushtuar urrejtja.

U mallëngjeva dhe i kërkova ndjesë milingonës për padashjesinë time. Ky akt kaq human më lidhi përgjithmonë me to. U zotova se do të bëja gjithçka për humanizmin e mëtejshëm të tyre. Pse jo? Kur me mijra individë janë zotuar të përhapin fjalën e Zotit që është Zot dhe s'ka nevojë ta përkrahin të tjerët, a nuk do të ishte njerëzore të përkrahje ca qenie të njera që s'kanë asnijë përkrahje?

Kaluan muaj. Unë isha bërë një nga propagandistët më të zjarrtë të punës së vyrtytshme të milingonave, aq sa gjuhën e ndjeja të mpirë nga lodhja. Po për habinë time, ata që më dëgjonin, - më të shumtët të njojur të mi, - më vështronin me ca sy të çuditshëm, dhe herë-herë vinin dorën tek goja, siç duket për të fshehur të qeshurat.

- Shoqëria njerëzore - u thoshja - është e mbushur me mëkate, urrejtje dhe fitxin vese. Eshtë provuar se atë s'e qeverisin dot njerëzit, qofshin ata perandorë, mbretër, a (rt) presidentë...

Njerëzit në fillim më kthenin krahët dhe pastaj, më vonë, bënин sikur s'më vinin re. Rodina e pandreqshme e njerëzve! Dhe Xhimi mendon t'ju shërbejë atyre duke u vënë në dispozicion kriesat etij. E kundërtat duhej bërë: milingonat, në vend të atyre krahëve ëngjëllorë, të kishin mantele të rënda ushtarësh dhe pastaj, me hap të rregullt të fillonin të zbrisnin prej periferisë në qendër me pishtarë në duar. Atëherë ta shikojnë njerëzit dhe veçanërisht ata, fëmijët, që më pëshpërisin nga mbrapa kudo që shkoj: cptz,cptz...Idiotët!

## *E gjalla me varrin e hapur*

Pasi u tundi dhe njëherë bastunin e thantë fëmijëve që gjatë gjithë rrugës e kishin ndjekur passelarg me thirrjet “e marra, e marra”, Bibo Shahini shtyti portën e hekurt dhe hyri në oborrin e shtëpisë së prindërve. Nga plloçat e paputhitura mirë delnin vende-vende tufa të gjelbërtë bari.

- Ua, dadje! Hajde, hajde! Të lumshin këmbët! - i tha nusja e vëllait, Esmaja, që u shfaq në ballkon me një kanë uji në dorë.

- Mos më thuaj hajde, por shpejt bëmë gati rrrobat se do të iki.

- Ç`thua?! Po ti akoma s’ke ardhur! Dale...

- Majft! Do iki të them. Do iki përfare. Do vdes. Merr vesh apo jo?! Pas pak vjen Xhebraili. Shpejt.

Kana, që Esmaja mbante në duar, ra në dysheme dhe u shndrrua në copra xhami dhe rrrokje të qelqta. Esmaja filloi të çirritë faqet dhe të shkulte flokët. Ishte më shumë një ritual, sepse thellë në vetvete ajo nuk dinte si t’i mirritë fjalët e Bibos: fjalë të martëzive të saj të zakonshme, apo fjalë që provonin profecinë për ditën e vdekjes së saj. Këtë, siç kishte thënë

Bibua atëherë. e kishte marrë vesh kur kishte vdekur herën e parë.

Bibo Shahini kishte vdekur njëherë. E kishin gjetur një mbasdite pa frysë, rënë përmbyt mbi shtrat. E varrosën me gjëmë e kujë. Veç pas dy ditësh një çoban kishte dëgjuar zëra që vinin nga varri dhifreshkët. Qysh atë mbrëmje e mori vesh gjithë fshati. Më kureshtarët kishin shkuar në vend. Ishte e vërtetë: nga varri vinin rënki me zëra. Në mbrëmjen e ditës së nesërme dikush tha se e kishte parë të ndjerën lugat. Kishte ardhur natën dhe i kishte derdhur bucelën me ujë. Kështu thanë dhe dy të tjerë që e kishin dëgjuar natën tek hiqte dërrasat e çative, të cilat. duke rrëshqitur mbi njëra-tjetrën, kërkëritnin sikur po kërciste dhëmbët një qenie skëterore. Të nesërmen dhjetë burra nga fshati, pa mundur t'i bënin ballë përgjërimeve të grave e drithërimave të fëmijëve, së bashku me vëllanë e të ndjerës. Petritin, kishin shkuar për t'i djegur varrin. Me një ndjenjë tmerri ata shikonin se sa më shumë pakësohej pirgu me dhë aq më shumë shtohej ankthi i tyre. Që poshtë (arkivoli tani s'duhej të ishte aq thellë) dëgjuan ca rënki me të lehta. E ngritën kapakun e arkivolit duardridhur e gjunjëkëputur. Bibua filloj të lëvizë dhe, pas pak, kur filloj të përpjekë qerpiqët, ata e ndjenë veten më të lehtësuar. Dy-tri ditë kishin mjaftuar që e vdekura të meritë ngjyrën e vendit ku ishte shtrirë: të baltës. Pas disa minutash hutimi çudia ia la vendin të zakonshmes. Burrat u kujtuan për gjynahun e madh që po bënin duke e lënë varrin hapur, ndaj u bënë gati të hidhnin lopatat e para me dhë. Por Biboja i kishte penguar. Ashtu lereni, mezi kishte arritur të mërmërinte, unë do të vij prapë.

Njeri nga burrat i vendosi dorën mbi sup dhe e pyeti me një zë të ndrojtur:

- Po si ndihesh tani, mos Bibo?

- Dërgoni haber tek trakajt dhe thuajuni se Osman pasnesër do të vdesë.

Atë natë bënë një darkë të thjeshtë. Gjithë farefisi bënte sikur hante duke përplasur lugët në sahanët e bakërt, të cilët lëshonin ca tingëllima shumë trishtuese. Seç ishte diçka që i pengonte' të ishin të çlirët. Befas Bibua, me një zë të ngjirur kishte thënë:

- Ata filluan të vijnë një e nga një. Kishin ca këmbë të holla si cingël dhe ca fytyra të zeza që mos o zot. Më vunë në mes dhe më pyesnin me radhë. I pari erdhi Magripi, ai që dhjetë vjet më parë e hëngri veremi...

- Ç'na thua, moj nënë?! Aq! Ti je e lodhur dhe e sëmurë. Kjo ka bërë vaki dhe gjetkë. Aq tani. Ha bukë dhe fli.

- Pastaj erdhi Matoja. Barkun e mbante me dorë. Siç dukej i dhimbnin plagët e cfurkut, kur ra mbi të tek vinte mullarin me bar. Pastaj të tjerët... Uleshin përballë me këmbët mbështjellë nënvete dhe më pyesnin... Pastaj erdhi një burrë i gjatë sa një gështenjë, i mbështjellë nga koka tek këmbët me një kamillaf të zi. "Bëtë gabim - tha ai. - Kjo s'e ka radhën tani. Je të hajë bukë e ngjiteni prapë lart". Prunë darkën. Ata filluan të merrnin copat e mishit në dorë. Ishte një mish sterër i zi, sikur t'i kishte rënë plasja. Filluan të hidhnin valle: ja na erdhi Biboja, po varri vende nuk ka...

Biboja u zgjua pas dyzetë e tetë orësh, pikërisht kur në lagjen e Pllakës u dëgjuan ulërimat e grave: kishte vdekur Osman Traka. Po atë ditë u mbart për tek shtëpia e burrit. Pas ca ditësh kishte ardhur tek ajo vizitor i parë. Ishte një djalë

i ri që i ishte mpirë gjuha nga që kishte shkelur xhindet. Biboja e kishte prekur dy-tri herë me duar dhe nëna që shoqëronte djalin e kishte parë se si ishte ngërçuar fytyra e saj. Bën për mua, kishte thënë dhe i kishte tundur të jëmës shuplakat e prapsme të duarve për ta nxjerrë jashtë.

Shumë të tjerë filluan të vinin më vonë: paralitikë, të verbër, të divorcuar të pafat, eremitë, somnabulë. Bibos i doli nami si shëruese e madhe. Po kish dhe nga ata që thoshnin se Biboja qe çmendur ditën kur u ngjall prapë. Disa druvare e kishin gjetur dikur tek varri i hapur i saj. Shkuante shtogjet dhe barërat e egra të mbira në pirgun e dheut dhe këndonte një ninullë. Këndonte sikur s'kishte përpala një varr, por një djep.

Esmaja, duke mbledhur coprat e kanës me fshesë, edhë kishte frikë se mos fjalët e dades dilnin të vërteta, edhe besonte se ato s'ishin gjë tjetër veçse profka. Por befas u drodh dhe klithi. Biboja kishte mbështetur kokën tek pragu. Tiparet e fytyrës i ishin zbehur, kurse në buzë i lëvrinte një buzëqeshje e çuditshme. Hijet, mendoi ajo me vete, hijet. Ajo kishte dëgjuar se në çastet e fundit gjithkujt i mblidheshin hijet e të afërmve, me të cilat ai flet, bisedon.

- Dade, të keqen, shpirt, xhan! - ra përbys mbi gjoksin e saj Esmaja.

Biboja shqeu sytë, u mundua të conte kokën dhe mërmëriti fare ngadalë:

- Mos më kthe moj nuse nga rruga ku jam nisur, mos...

Lëshoi grahmat e fundit dhe mbylli sytë përgjithmonë. Esmaja, e ngrirë aty, e vështronte dhe s'dinte ç'të bënte. Xhufkat e zeza të shamisë së Bibos iu dukën si berimanga të

mëdha që, ja, pas pak, do të ngjiteshin nëpër murin e lyer me gëlqere të bardhë, do të fshiheshin strehëve dhe do të prishin natën përtë dalë përsëri. Natën, kur lëvizin hijet e kësaj bote...

## *E fshehta e lekurës me kurabie*

Kishte ardhur vjeshta me shirat dhe bubullimat e para, bubullima që i bënин gjarpërindjtë të fshiheshin thellë nën tokë. Pritej kështu që njerëzit të çlirohen prej maktheve që u ishin shkaktuar gjatë gjithë asaj vere të thatë nga prania e gjarprit astrit. I gjatë sa një tra (siç thoshnin), me dy krahë të vegjël tek sjetullat, ai pasi llupiste qengja, dhen, bile ndonjëherë dhe dema, shullëhej pastaj në një kodër të sajuar prej një pirgu varresh, pak më larg të cilës shtrihej një kulla~~më~~ thanash të egra. E pra tanë që nisën bubullimat e para dhe dihej që gjarpëri astrit do të fshihej në murishtet e vjetra dhe aty, duke i përkitur llojit sojzës të gjarpërindjve, do të shlyente mëkatin fillestar duke ngrënë baltë, mbi njerëzit kishte rënë një fatkeqësi tjetër: sëmundja e Ermirës, bukuroshes fjalëpadalë të fisit të pupulekëve. E kishin gjetur një ditë ulur këmbëkryq në barin e oborrit të shtëpisë para një tarkuze lara-lara, të lidhur nyje tek njeri nga cepat, me flokët e shpleksur dhe fustanin e grisur, tek e përkëdhelte tarkuzën

dhe i këndonte një ninullë: ullullaj, ullullaj, gjarpër i vogël mos më qaj. Njerëzit që e panë ishin pataksur dhe kishin vënë duart në kokë: pastaj, pasi u qetësuan, iu afruan dhe filluan t'i flisnin butë. Mos më preknij!, kishte klithur ajo dhe, pasi kishte mbledhur buzët përpara, kishte lëshuar një vërvshëllimë të çuditshme. E kishin çuar menjëherë në spital.

Sëmundja e Ermirës duhej të kishte filluar ditë më parë. Duhej të kishte filluar që atë ditë kur e ëma e kishte gjetur zhveshur në një nga cepat e dhomës së gjumit. Qiri e bardhë, ajo bënte gjeste sikur ledhatonte dikë dhe rënkonte gati me dënesje. Ishin këto dënesje që e kishin detyruar të ëmën të hapte derën dhe ta gjente ashtu, në atë farë feje. E ëma kishte tërhequr pas vetes derën dhe ishte mjaftuar vetëm duke shkulur faqet e duke bërë: pu, puu!... Ulur në sofa, duke pirë mbasditeve kafe me fqinjet, të cilat janë të gjendura në kësi rastesh, ajo kujtonte *copa-copa* shenja e sinjale që tregonin fillimin e sëmundjes së vajzës së saj, por ajo e marra s'iu a kishte vënë veshin.

Ermirën e mbajtën fajë pak ditë në spital. I dhanë barna, por sëmundja e saj s'u shërua. Të vinte keq që tiparet e mrekullueshme të fytyrës së saj po prisheshin e deformoheshin. Rrinte si e fjetur dhe e përhumbur duke përsëritur fjalë pa lidhje: zemër, xangara fangara, shpirt. Të afërmit u munduan mos zbulonin tek këto fjalë lidhje të saj me ndonjë djalë, por që e pamundur, sepse njerëzit e qytesës sonë, të cilët janë të lidhur në mënyrë të atillë sa goja e njerit ri tek yeshi i tjetrit, do ta kishin marrë vesh me kohë. Ditët që pasuan Ermira filloi ta mbante dorën e djathtë gjithnjë e më lait. Vetëm atëherë të afërmit panë se sjetulla e saj që enjtur e fyrrë për ibret si pasojë e një të thati. Ia mjekuan me

fletë mëllage dhe të nesërmen kur erdhi koha t'ia hapnin. ç'të shihje. o zot! Porsa hoqën mëllagën i thati u hap këlltup dhe prej tij doli një kokërr vezë. e cila ra butë mbi divan. Ishte e bardhë dhe e vogël sa një vezë pëllumbi. Njerëzit s'patën kohë të flisnin e të komentonin këtë çudi, sepse. sa e mori dikush vezën në dorë ajo u hap si boçe pambuku dhe u pa se brenda saj ndodhej një unazë e artë. U bë e qartë se sëmundja e Ermirës s'ishte e zakonshme. Shenjat e reja flisnin për lidhje me qoftëlargun a ëngjëjt. Asaj mund t'i bënte derman vetëm Biboja, shëruesja që kishte vdekur njëherë dhe qe ngjallur prapë.

Ç'ka kjo përzja e hënës. kishte thënë Biboja kur Ermira hyri në shtëpinë e saj. Pastaj. pasi kishte folur e nomatisur, i kishte thënë prerë: zhvishu, lakuriq të them! Biboja kishte marrë në duar këmishën e natës të Ermirës. Ishte një këmishë e hollë si lëkurë gjarpëri me kurabie të vogla. Malukat, si ia bëre që lëkurën tënde ia veshe kësaj vajze kërthi? Kishte thënë Biboja. E leu këmishën me vajguri dhe i vuri flakën. Ndërsa Ermirën e mbuluan djersët e ftohta dhe të dridhurat, shtjellat e tymit formonin dhe shformonin trajtat e një gjarpëri. Shko tani, kaq qe, tha Biboja duke fërkuar duart.

Kur u kthyen në shtëpi panë se unaza e artë. të cilën e kishin lënë mbi oxhak, s'qe më aty...

## *Asgjë s'ka ndryshuar*

Ftesën e Glendës për të vizituar lokalim e përfunduar, të ndërtuar lart, në kodrën e vetme të qytetit, tani, pas një viti e ca, e prita pa qejf. As vetë nuk e di pse. Mbështetje nga shkaku i Andit. Ajo, si ta kuptonte këtë. futi dorën në çantën e zezë në formë gjysmëhëne dhe më zgjati një pako të vogël të mbështjellë me letër të bardhë.

- Merre - më tha, duke më parë gëzueshëm në sy. - Ma ka dhënë Andi pér ty. Eshtë një kasetë me këngët e Matjësë.

Të marritë dreqi me gjithë Andin tënd, gati mërmërita. Ç'ke që ma ze prapë në gojë. Ai është i njohuri yt dhe jo i imi. Bile as tani s'ia fal vetes që korrikun e vitit të kaluar pranova pér të shkuar me të, Glendën dhe Verën tek sterra që tashmë është bërë lokal.

E mora pakon në dorë dhe u nisëm. Me pulovrën e bukur, të hedhur shkujdeshëm supeve dhe me flokët e bëra rica, Glenda dukej më simpatike. Shkallët e lokalit ishin po ato: të pjerrëta, sa dy radhë më poshtë mund të shkelja me këmbë (mos o zot!) kokën e Glendës. Me mendjen time i zhvesha muret nga suvaja, ua hoqa rimeson prej arre mobiljeve.

Gjithçka m'u duk si më parë...

- Ja harqet, portikët, kolonat... - na kishte spjeguar ciceroni i muzeve të qytetit. - Askush s'mund ta thotë me siguri ç'ka qenë më parë kjo sterrë: tempull, faltore, a bodrum verërash a pijesh...

Befas ciceroni, duke e kuptuar që s'po dëgjonin atë por ca tinguj të çuditshëm që vimin nga ujrat e ndenjura, kishte shtuar me qetësi:

- Janë gjarpërinjtë e ujit. Kështu këndoijnë kur ndizet vapa. Janë të parrezikshëm. Veç herë-herë nga ajo e çara aty (ai tregoi me gisht në kubenë e tavanit një vrimë të hapur sa një mazgallë) hyjnë gjarpërinj dhe nepërka helmuese. Pinë ujë dhe dalin duke u zvarritur shkallëve...

Diçka duhet të kisha folur me vete, përderisa Glenda, që po ecte me atë mënyrën e saj qiparizore drejt një tavoline të lirë, ktheu kokën mbrapa, më kapi lehtë nga krahu dhe më pyeti se ç'kisha. Ç'kisha?! Ç'kishte ajo me mua që më kishte têrhequr drejt këtij vendi, të cilin, as në muzgjet e ulur në stolat e parkut, as në mbrëmjet e vona kur e përcillja në shtëpi s'e kisha zënë më me gojë.

U ulëm në një tavolinë, fshehur pas një kolone. Glenda mbështeti bërrylat mbi të dhe më buzëqeshi. Kishte një buzëqeshje të mirë, fëminore. Vetëm një herë mbaj mend të mos ketë qeshur kështu: atë ditë kur e putha. Cepi i buzës së saj ishte shtrirë anash, a thua se kështu ishte më i gatshëm për ta rrëzuar prej andej të puthurën. As kishim folur, as ishim spjeguar. As për Andin s'më kishte folur më. Se ishte Andi ai që, me mënyrën si qeshte, si fliste, më kishte zemëruar më shumë atë mbasdite korriku...

Unë, duke i thënë ciceronit: ç'na thua atëherë se

askush nuk e di ç'ka qenë më parë kjo shpellë, kur dihet shumë mirë se ajo ka qenë varrezë shirash e gjarpérinjsh? Andi duke qeshur me zor. Vera duke treguar historinë e një gruaje që kishte parë dy gjarpérinj të çiftosur dhe ishte penduar që s'iu kishte hedhur një shami në kokë për t'u bërë shëruese e atyre që s'lindnin fëmijë. Andi: ha, ha, ha!...se s'i më duken fjalët e kësaj zonjushes (më fal që s'ta mbaj mënd emrin): të vjetra, bien era myk si muret e kësaj sterre. Po të ndodhë kështu me gjarpérinjtë, kushedi ç'ndodh po t'ju hedhësh një shami njerëzve të çiftosur. Po dal që sonte nga parku...

- ...gjarpérinjtë dhe kupa me lule. Blerti!

- Çfarë?!

- Ku e ke mëndjen? - më shkeli syrin me djallëzi Glenda. - Po të pyesja ç'kuptim kanë këta gjarpërnj dhe kupa me lule?

Vështrova aty ku tregonte gishti i saj. Vërtet, në drurin e kolonës ishin gdhendur motive të tillë. U bëra gati t'i flisja për sahanin e florinjtë të Safet Shurdhit, për gjarpérinjtë dhe lulet e gdhendura brenda kupës; t'i tregoja se si u prekte me gishta gushën të sëmurëve me shytë, pasi kishte fërkuar me ata gishta gjarpérinjtë. Por heshta. Glenda s'i kishte thënë, asnjë fjalë Andit vitin e kaluar, veç e shikonte trishtueshëm.

- Pasta dhe kafe - e porositëm kamarierin.

E vështrova Glendën në sy. Ajo buzëqeshi. Të gjitha buzëqeshjet ishin modele të njera-tjetrës.

- Kamarier! Si është hequr uji prej kësaj sterre? - pyeti ajo.

- Aty lart - tregoi me gisht në tavan - ka qenë një e çarë e madhe. Prej andej me anë të një vinçi, futnin brenda një fuçi.

Mbush e zbras. Për çudi gjarpérinj nuk dolën. Ishin futur me siguri gurëve.

Paguam lekët dhe dolëm. Përjashta na priste një quell i hirnosur vjeshte që nuk premtonte asgjë. Glenda, e penduar siç dukej që kishte ardhur me mua në një ditë mërzie, nuk tha asnjë fjalë gjatë rrugës. U ktheva në shtëpi i lodhur. Kasetën e Andit e kisha në dorë. E vendosa në magnetofon dhe prita të dëgjoj muzikë. Por në vënd të tingujve, o zot!... Në kasetë s'ishin regjistruar këngët e Matjesë, por këngët e atyre: gjarpérinjve. Xi, xi.xi...ia bënte kori i tyre. Dhe pastaj ca klithma e pasthirrma njerëzore: mos, ah, mund të vijë ndonjë. Xi, xi, xi... Mos, mos, mos... U bëra dyllë i verdhë. Ishte zëri i Glendës. U mundova ta përbaj veten dhe të arsyetoja me cinizëm: dashuri në sfond gjarpérinjsh. Dashuri e helmuar, ptu! Dhe vazhdova: në sterrë mund të mos ketë patur kurritë gjarpérinj. Ciatjet që kishim dëgjuar vinin nga gjoksi i Andit, kurse ne na dukej se vinin nga sterra... Vura kokën në jastëk dhe qesha me gulshe...

## *Përdhunimi*

### 1.

Sonte ishte nata e dytë dhe ai do të flinte me të. Zbuloi krevatin. Kofshët e bëshme, nën dritën e zbehtë, kishin një bukuri të bardhë tronditëse. Pastaj pjesën e batanijes e ngriti lart, gjer tek kërthiza. Fërgëlloji, e kaplluan të dridhura e u bë gati t' i hidhej përsipër, por e mblodhi veten: e kishte vendosur të mos ta rrëmbente pasioni dhe gjithçka ta kryente sipas ritualit të natës së parë të martesës. Shkoi tek dollapi dhe nxori një palë...breçkëza. (Atij që kur kishte parë nallbanët të mbathnin kuaj, i vinte të pështirë nga fjala “mbathje”, kurse fjala tjetër: “brekë”, që mund të përdorej në këtë rast, ishte e përshtatshme për vajzat dhe vithe kodrinore e jo për një fishkull të brishtë bari, siç ishte Najada). Ishin të zeza e të lehta si krahë dallëndyshesh, qëndisur me një dantellë të bardhë anash. I mblodhi shuk në dorë, i puthi me afsh dhe i hodhi mbi krevat. Vishi, i tha...E po mirë, meqë s`dashke, po t'i vesh vetë atëherë. Hapi dhe pak këmbët! E di, e di që s'mundesh, por s`ke ç`i bën! E lëvizi sa majtas, djathtas dhe, me mundim, arriti t`ia veshë ato. E vështroi dhe njëherë para

se të zhvishej vetë. Mrekulli fare, tha Bardhë e zi. Një realitet si në romañet e shkrimtarëve socialistë. U shtri në anë të saj. I shtypi majën e hundës me gishtin tregues dhe i çuçuriti tek veshi: Najada, pa më thuasj që është për ty virgjëria? Virgjëria zoti preofesor, u përgjigj po vetë, duke imituar të folurën e saj, është një cipë e hollë qepe. Çdo nënë kur lind vajzë, pret një kokërr qepë, i merr cipën e hollë dhe me tre gishta e fut brenda seksit të vajzës së saj. Shkëlqyeshëm. S'ka nevojë për më tej. Dhe tanë konkretisht: nga teoria në praktikë. Ta shohim sa të drejtë ka Marks.

Envali i hoqi me shpejtësi...të tijat (gjithnjë mungon fjala e saktë) dhe, pasi i flaku mbi dysheme, filloi t'ia heqë edhe Najadës. E përkëdheli me duar në supe dhe gjoks dhe e puthi në gushë dhe në rrëzën e veshit. Duart po zbrisnin gjithnjë e më poshtë, por e ndjeu se diçka nuk po shkonte. Të ftohtit e ndjeu tek pjesa e kofshëve dhe balqthi. Vendosi faqen e tij mbi faqen e Najadës dhe filloi të dëneste. Pas disa çastesh e mblođhi veten dhe hovi prej shtratatit në dysheme. Putanë, kurvë, bushtër e poshtër, i ulëriu. Me atë grekun e lig bën që t'ë do qejfi, kurse me mua...Po do ta shohim: edhe ai s'ka për të të gëzuar. Mori diku një çekan dhe u sul drejt portretit. Ngriti dorën dhe goditi pikërisht aty ku duhej të ishte seksi i saj. Coprat e allçisë u bënë thërrmija dhe ia lanë vendin një gropëze të zezë.

## 2.

Envali e kishte rrëmbyer portretin në allçi "kërcimitarja" në mesnatën e ditës së djeshme. Rrëmbimi i tij

ishte një ndërmarrje e rrezikshme, por ai i kishte marrë parasysh të gjitha: hetuesinë, burgun, kamzhikët. Pothuajse e dinin të gjithë se skulptorit V.N, kur kishte punuar portretin i kishte shërbyer si model Najada C. Sapo portreti u vendos në qendër të lulishtes marrëdhëniet e Envalit me Najadën filluan të ftohen. Marrëdhëniet?! Të thuash të vërtetë ato s'ishin gjë tjeter veç ca pëershëndetje në rrugën e përbashkët, ndonjë shoqërim i rrallë deri tek shtëpia e saj dhe veçanërisht ajo “natën e mirë”, e shoqëruar me një anim të lehtë të kokës nga ana e saj. Por dhe kaq mjaftonte që Envali ta mbushte shpirtin me psherëtimë dhe të shpresonte për një dashuri të madhe. Kurse që kur ishte vendosur në lulishte portreti i saj, ai ndjeu që trarët e shpirtit po ia gërryente një krimb i vockël, i bardhë. Kërr-kërr, ia bënte ai, kërr-kërr: shpressoje të ishte vetëm e jotja, kurse tani është e gjithë qytetit. Kërr-kërr: ti ende s'e di ç'formë kanë pulpët e saj, kurse me mijra njerëz soditin kofshët, këllqet dhe gjoksin e saj.

Pas grindjeve më Najadën (grindje ai quante vështrimin e mërritur dhe kthimin e kokës anash kur ndeshej me të) filloi t'i kalojë më të shumtat e mbasditeve i ulur në piedestalin e portretit të saj. As fliste, as queshte. Aty i dëgjonte të gjitha ç'tuheshin për të: vlerësimë, të qeshura, pasthirrma, sharrje, mërmërima nën zë. Një ditë s'duroi dot më. Një djalosh flokëgjatë e kishte soditur portretin në heshtje, e kishte puthur në rrëzë të kofshës dhe kishte thënë: “Ta martsha të shpirtit! Një natë me ty dhe le të vdes”. Envalit i kishte kërcyer gjaku në kokë dhe e kishte goditur. Mes kacafytjeve dikush thirri: policia, po vjen policia! Që të dy u larguan në drejtime të ndryshme.

Po shkaku i rrëmbimit të portretit s'kishte të bënte aq

shumi me këto, se sa me martesën e afërt të Najadës me një tregetar grek. Kërr-kërr: ajo po ikën për fare. Kërr-kërr: kurrë s'do ta shohësh në jetën tënde. Një miell i hollë, i bluar në trarët e shpirtit, duhej të derdhej me siguri në stomak, përderisa në këto çaste ai ndjente të përziera. Në djall të venë të gjitha, kishte thënë me vete. Ai greku i poshtër le të marrë Najadën e vërtetë, të vdekshme, unë do të marr të rremen, të përjetshmen. Dhe u nis. Sytë i rrötullonte si mace e egër sa majtas, djathtas. Kur arriti në lulishte i vuri supin portretit dhe e rrëzoi. Pastaj, si e mbështolli në një thes të gjatë nailoni, e hodhi në shpinë dhe u nis. Ishte i rëndë sa një kështjellë. Në shtëpi arriti i mbytur në djersë dhe me sy të errësuar. E vendosi portretin mbi krevatin e vetëm, u shtri dhe vetë në anë të tij dhe e zuri menjëherë gjumi.

### 3.

Një gropë e errët, e zezë; pra një vart, tha Envali duke vështruar vendin ku kishte kryer masakrën. Hi,hi,hi!...Nesër në lajme do të thuhet: vidhet një vepër arti në qytetin X. Grabitësit e kanë nxjerrë atë jashtë kufinjve. Hi,hi,hi!...Idiotët. Jashtë kufinjve do të dalë Najada dhe jo shpirti i saj. Po si gjithmonë gazetarëve s'iu bëjnë përshtypje shpirtrat...Një gropë e errët, e zezë...Po ajo mund të mos jetë më kështu, pëshpëriti i ngazëllyer, duke iu kujtuar diçka e largët.

Kur ishte në shkollë (ishte në atë moshë kur djemtë rrëzojnë stilolapsat nga bangat vetëm që të shikojnë kofshët e vajzave) mësuesi iu kishte folur në një orë zoologjie për ndërzinmin e lopëve. Vajzat qeshnin mbyturazi me kokën

ulur. Djemtë, pas orës së fundit, kishin mbyllur derën nga brenda dhe kishin filluar komentet. Luani, nxënësi që i përsëriste klasat nga dy herë, iu kishte thënë se veterinerët iu vendosin demavenjë llistikëtengrohtë, valë, përt iu mbledhur spermën. Këtë e kishte spjeguar në mënyrën më solemne, duke u vënë në pah atyre spurdhjakëve epërsinë e moshës.

Kjo ndodhi, që kishte kohë që e kishte harruar, iu kujtua tek po përsëriste: një gropë e errët, e zezë... Qeshi me ligësi. Ndezi furmelen dhe vendosi mbi të një tenxhere me ujë. Kur uji u ngroh mirë e hoqi dhe e vendosi në një qeskë të vogël plasmasi. Tani po, tha, pasi e vendosi qeskën brenda gropës së zezë dhe e ngjiti anash. U zhvesh. Dora filloi t'i ledhatojë pjesët e rrumbullakëta. Filloi të dridhej. Ishte si në jerm. E futi gjësendifin e vet brenda qeskës. Një nxehësi furre iu shpërnda nëpër trup. Bëri disa nga ato lëvizjet steriotipe para mbrapa dhe, në kulmin e kënaqësisë, hoqi me shpejtësi qeskën dhe gjithë spermën e derdhi brenda barkut zgërfallë të portretit. Pastaj fshiu djersët dhe u ul buzë shtratat me mjekrën mes duarve. Dëgjo Najada, filloi t'i flasë i menduar: pas nëntë muajsh do të lindësh një kolopuç të vogël prej allcie. Ai do të jetë fëmija jonë i përbashkët, të cilin do ta rrit vetë, përderisa ti do të rritësh fëmijë prej mishi me atë grekun e poshtër. Ja, kaq kisha për të të thënë, tha Envali dhe u shtri ndanë portretit për të fjetur. E zuri një gjumë i thellë, i rëndë...

Pas disa ditësh portreti i kërcimtares ishte vendosur përsëri në lulieshten e qytetit. Dëmtimi i tij aty ku bashkoheshin të dyja kofshët dhe veçanërisht ai shënimi poshtë: "lind pas nëntë muajsh", i bënte kureshitarin te i jenin gjithë ne më të ndryshimet. Të zene me keto spjegime (qyteti yme eshtë i vogël sa një lëvozhigë arre, ku të gjithë e njohin njëri-tjetrin)

ata s'kishin si ta vinin re një taksi të bardhë, në të cilën një nuse dhe një dhëndër niseshin drejt kufijve të jugut. Bile ata s'kishin si ta dinin që një djale, i ulur tek piedestali ishte i vetmi që e kishte parë taksinë; menjëherë pastaj ishte zbardhur, kishte rrrotulluar sytë dhe kishte mbetur ca çaste pa ndjenja i mbështetur pas portretit.

## *Shndrrimi i Mirita Z. në ulkonjë*

Po të kaloni nga rruga e spitalit, në një nga dritaret e katit të katërt të tij, mes hekurave të trashë sa gishti, do të shikoni një grua me fytyrë të lemerishme që ulërin si ulkonjë. Eshtë Merita Z., e shoqja e të vyrtytshmit Andrea Z., shef në bashkinë e qytetit për problemet komunale. Sëmundja e saj filloi gati këtu e një muaj më parë, një të premte në mëngjes, kur ajo porsa u ngrit nga gjumi dhe ende pa bërë tualetin, duke mbledhur flegrat e hundës. I kishte thënë të shoqit: Andrea, çudi me ty xhanëm, si s'e ndjen që e gjithë shtëpia bie një erë të rëndë. Bie erë shtrofke shtazësh? Andrea, që po i ruhej para pasqyrës, kishte kthyer kokën dhe, falë shkumës së rrojes, kishte arritur ta fshihte përskuqjen dhe tronditjen. Në fjalët e saj, të thëna me shkujdesjen e një amvise, ai ndjeu se ëndrra e tij po kthehej nga një irealitet i largët fantastik në një realitet të afërt kërcënues.

Gjithçka kishte ndodhur pak ditë më përparrë asaj të premteje, kur ai dhe disa gjahtarë të tjerë kishin shkuar për të

vrarë në pyllin e lajthive ujkun e çalë. që po bënte batërdi në bagëtitë. Rasti ia kishte sjellë Andreas në shteg. Kishte qëlluar me gjakftohtësi. Para se ujku të plandosej përfundimisht në tokë, e kishte parë si ishte zvarritur deri tek trungu i lajthisë më të afërt, të cilën e zhvati me dhëmbë sa u zbardh. Atë natë, kur po bëhej gati të flinte, dëgjoi një si ulërimë të largët. Do ta kem nga lodhja, mendoi. Dhe vërtet: pas orëve të gjata në pritje të gjahut, kishte vazhduar rrjepja e lëkurës së tij, shkulja e dhëmbit të parë, dhëmb, i cili, sipas zakonit të gjahtarëve i dhurohej vrasësit të bishës, për t'i sjellë fat. Por ulërima, këtë herë më e qartë, u dëgjua nga ana perëndimore e shtëpisë. Andrea i hodhi sytë të shoqes: ajo i kishte kthyer shpinën dhe gërhiste. Në majë të gishtave doli në ballkon. Priti disa çaste. Ulërima u dëgjua përsëri, por këtë herë nga lindja. Doli andej. Pemët e fshehura në errësirë u ngjanin ca kafshëve gjigande, të cilat, pasi kishin fshehur putrat nën gjoks, po bëheshin gati të hovnin përpjetë. Ulërima u dëgjua nga veriu. Andreas iu ngritet flokët përpjetë. Mblodhi nëpër pjesët e trupit ato thërrimeza burrërie që i kishin mbetur dhe shkoi tek dritarja e vetme që binte nga veriu. Asgjë, përvëç klithmës vajtuese të një kukuvajke që ia bëri më ndjellazezë frikën. Do të më kenë bërë veshët, tha me vete, por njeriu tjetër brenda vvetvetes i pëshpëristë vazhdimisht se s'ishte ashtu.

Duhet të ishte në të gdhirë kur Andrea, i mbytur në djersë, hovi prej shtratit përpjetë. Fërkoi sytë dhe, pasi u ambientua me sendet përreth, u bind që ishte në shtëpinë e vet. O zot!, shqyr që s'është e vërtetë, mërmëriti me vete. U mundua ta riprodhonte edhe njëherë ëndrrën: i bëhej sikur ishte në zyrën e vet, kur befas troket dera dhe çalë-çalë futet

brenda një ujk i vjetër. I shkel syrin dhe ulet në karrigen përballë. E vështron ngultas, zbardh dhëmbët (dhëmbi i parë i mungonte) dhe qesh.

- Mos u çudit - i tha. - Jam vërtet unë, shpirti i ujkut që vrate në pyll. Kam ardhur të të pyes: ç'të kisha bërë që më vrate?

- Kishe shfarrosur me dhjetra bagëti - i ishte përgjigjur duke u gëlltitur Andrea.

- Ua, ua! Pa shiko ç'na thënke! Vemë bast se ti ke ngrënë më shumë desh se sa unë? Unë ha i detyruar, sepse ka një ligj natyral: po të mos i haja unë bagëtitë, ato do të shumoheshin aq shumë sa do hanin ju, njerëzit. Po ty, a nuk të sjellin përjavë vartësit nga një dash në shtëpi? E pra unë s'kam vartës për të më shërbyer. Unë e nxjerr me thonjtë e mi bukën e gojës. Apo mos e ke harruar këtë vëllai im mishngrënës? Ja dhe pak ditë dhe do t'i moduloj këto tipare të rreme njeriu: do të t'i zgjat përpëra turinjtë, do t'i egërsoj sytë, do të ta mbuloj me lesh të gjatë gjithë trupin, shpirtin tim do ta fus brenda tëndit.

Me të thënë këto fjalë ujku kishte përmjерë në dysheme dhe, pasi kishte uluritur fort, kishte dalë jashëtë duke përplasur derën. Ishte ajo ulërimë që i kishte nxjertë gjumin Andreas.

Andrea nuk i tregoi gjë të shoqespër ëndrrën. Ndonëse ëndrra përsëritez çdo natë me të njëjtën ritmikë, me të njëjtat makthe, ai vazhdoi ta ruante sekretin gjer atë të premte në mëngjes, kur Merita i kishte thënë: Andrea, çudi me ty, xhanëm, si s'e ndjen se shtëpia bie erë të rëndë, bie erë shtrofke shtazësh? E pra, atë ditë, pasi kishte mbaruar së rruari, Andrea i kishte rënë të shoqes në sup dhe i kishte thënë me trishtim:

- Merita, më duket se po bëhem ujk.

Merita kishte qeshur aq fort sa filxhanët dhe gotat në rastin përballë u tundën dhe tingëllinë, thua po qeshnin dhe ato me të qeshurën e tyre kristalore.

- Pika burrit! Si s'hoqe dorë nga çilimillëqet mor i zi!

- E kam seriozisht - i kishte thënë ai dhe i kishte treguar për ëndrrën që shihte çdo natë.

Andrea po dobësohej përditë. Kur ishte në punë, sa herë trokiste dera, i dukej se do të hynte e do të ulej në karrigen përballë Ai. Një ditë dalloi mbi pllakat e dyshemesë një njollë të verdhë. U ult i merre erë: binte tamam erë urine. Doli me vrap në rrugë. Tani filloi të mbyllej në shtëpi pa rënë errësira. Mendimet e tij për një hakmarrje providenciale ia nguli dhe të shoqes në kokë. Andej nga mesnata zgjoheshin të dy të trembur nga ca ulërima që asnjëherë s'u dihej drejtimi nga vimin. Si dy zogj që i zë shtërpërgata, tulatin kokat në gjokset e njeri-tjetrit dhe s'fisnin me orë të tëra: kështu disa netë me radhë derisa erdhi ai mëngjesi fatal, kur Merita u zgjua mes klithmash. Aty, tek rrumbullaksia e supit dukeshin të thella e të freskëta gjurmët e dhëmbëve të të shoqit. Vetë ai ishte ulur galiç në dysheme, me mjekrrën mbështetur mes dy shuplakave. Merita, ashtu, gjysëm e përgjumur e gjysëm e lebetitur, ishte gati t'i bërtiste, t'i thoshte psh hajvan, ose të paktën ta pyeste: ç'bën?, kur ai, duke brejtur thonjtë me dhëmbë kishte filluar të dëneste me gulçe.

- Kam një grykësi ujku. Dua mish, mish të gjallë, të papjekur.

Merita kishte bërtitur aq fort sa ishin mbledhur komishinjtë. Ata pasi bënин pyetjet rutinore në kësi rastesh, pyetje ku ndihej një shqetësim i rremë, ia kishin ngulur sytë

fytyrës së Meritës. Në fytyrat e tyre kishte rënë hija e një frike të çuditshme. Sapo kishin ikur ata Merita ishte parë në pasqyrë. Asgjë për t'u shqetësuar, me përjashtim të disa puçrave të kuqërremta në fytyrën e saj prej ikone.

Për dy ditë me radhë shtëpia e Andreas u mbulua nga një heshtje misterioze. Ishte një heshtje që paralajmëronte kobe. Komishnjtë kthenin kokën andej, bënин gjeste dhe pëshpërisnin dhe ia bënин :nxék, nxék. Kjo heshtje e virgjér varrezash u zhbë andej nga paraditja e ditës së tretë, kur nga shtëpia u dëgjuan britma dhe ulërima. Njerëzit që erdhën panë një tovolli sendesh të hedhura mbi njëra tjetrën osc të bëra copë-copë: gota, pjata, karrige, tesha, jorganë... Mes kësaj zallamahie, duke u vërtitur nga njeri cep i dhomës në tjetërin, me fytyrën e çjerrë me thonj, nga ku kishin mbirë ca qime të zeza, vërtitej Merita. Kurse Andrea, me një pamje të trembur, me sy të zgurdulluar, ishte ulur mbi një uturak porcelani. I çuan menjëherë në spitalin psikiatrik. Kështu, po të kaloni nga rruga e Spitalit dhe në njérën nga dritaret e katit të katër të tij, mes hekurave të trashë sa gishti të shikoni një grua me fytyrë të lemerishme, ta dini që është Merita Z.

# Lënda

1. Magjistarja	3
2. Një telegram të gjatë vetes sime	4
3. Galloshja e vjetër	9
4. Dylbitë	13
5. Tre gisht nder	17
6. Makina e zezë	20
7. Më tha një palmë	23
8. Milingonat	24
9. E gjalla me varrin e hapur	28
10. E fshehta e lëkurës me kurabie	33
11. Asgjë s'ka ndryshuar	36
12. Përdhunimi	40
13. Shndrrimi i Merita Z në ulkonjë	46

**Realizimi në Kompjuter Firma Fidia & Miron  
Shtypur në Republikën e Shqipërisë  
Shtypshkronja UEGEN - 1996**



**Balil Gjini**

Tre gisht nder  
**UEGEN**

049

Prozë  
1996

Çmimi i shitjen  
në librari      100 lekë